



RRUGA "ELBASANI" TIRANE

Tel/Fax ++355 4 2452610

Prot. _____

Tiranë, _____ 2015

Lënda: *Përcillen mendime rreth Projektligjit*

REKTORATIT TË UT-së

Në mbledhjen e Këshillit të FGJH më date 28.01.2015, u diskutua Projektligji, i cili u ishte shpërndarë më pare personelit akademik dhe jo akademik. Nga diskutimet dhe sugjerimet edhe personale të personelit, po paraqesim në vijim disa mendime e sugjerime

Arsimi i Lartë në Republikën e Shqipërisë është pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të lartë. Qeveria shqiptare ka nënshkruar të gjitha konventat dhe marrëveshjet që burojnë nga procesi i Bolonjës.

Karta e Bolonjës ka katër shtylla themelore, mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë institucionet e arsimit të lartë: Autonomia akademike, institucionale, politike dhe financiare

Projektligji, në shumë prej neneve të tij, bie ndesh me kornizën e Kartës së Bolonjës.

1. Autonomia akademike dhe politike

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 7 thuhet shprehimisht: “Autonomia e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”

Kjo dispozitë e Dokumentit themeltar të Shtetit shqiptar ndalon ndërhyrjen e shtetit në veprimtarinë e kërkimit shkencor dhe të mësimdhënies.

Projektligji i propozuar bie në kundërshtim me këtë dispozitë të Kushtetutës së RSH, në disa prej neneve të tij:

Neni 3, pika 2: *“Shteti vlerëson cilësinë e veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore shkencore në institucionet e arsimit të lartë, si premisë për mbështetjen financiare të tyre”*. Pra, vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj të kërkimit shkencor kryhet vetëm për qëllime financiare e jo në dobi të mbarëvajtjes së këtyre dy veprimtarive. Kjo, gjithashtu, krijon hapësira për matje subjektive të cilësisë, duke prodhuar korrupsion dhe shmangie të konkurrencës së ndershme, gjë që do të pamundësonte të drejtën themelore të individit për mundësi të barabarta.

Neni 3, pika 3: *“Shteti krijon mekanizmat dhe monitoron funksionimin e IAL-ve, duke shërbyer si rregullator i sistemit të arsimit të lartë”*. Kjo nënkupton që monitorimi i funksionimit të IAL-ve përmes mekanizmave të krijuara nga shteti çon në vendosjen e kontrollit të centralizuar dhe absolut mbi IAL-të. Në shoqëritë e vërteta demokratike, shteti e kryen rolin e kontrollorit përmes nxjerrejs dhe detyrimit të zbatimit të ligjeve në përputhje me Kushtetutën në fuqi. Në demokracitë e pavërteta, Shteti shndërrohet në pronar të institucioneve.

Neni 7: Në disa prej pikave lexohet ndërhyrja e Shtetit duke cënuar autonominë e IAL-ve. Pika 2: *“Ministria monitoron zbatimin e programeve të miratuara”*. Nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për programe të miratuara nga

Ministria në kuadër të zhvillimit të Arsimit të Lartë apo për programe mësimore dhe kërkimore shkencore. Po kështu, shkelje flagrante të autonomisë janë pika 3, gërma ‘c’ dhe ‘ç’ të nenit 7.

Neni 8: “*Këshilli i Arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*”: ky nen ligjëron ngritjen e një strukture tërësisht politike, përmes njerëzve të emëruar nga kryeministri dhe, si i tillë, do t’u shërbejë interesave të qeverisë. Gjithashtu, në ligj, nuk janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes për anëtarët e këtij këshilli dhe as mënyra e organizmit dhe funksionimit të tij, duke e lënë këtë të përcaktohet më pas me VKM. Ngritja e këtij këshilli, siç është parashikuar në projektligj, është antikushtetues, pasi garanton ndërhyrjen e drejtëpërdrejtë të kryeministrit në pavarësinë e IAL-ve.

Shkelje flagrante të autonomisë akademike është mënyra e ngritjes së QSHA, kompetencat dhe funksionimi i saj. QSHA-ja mund të jetë një qendër e grumbullimit të të dhënave të nxënësve që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë. Kjo qendër mund të merret me matrikulimin e studentëve në të tria ciklet e studimeve, duke mos lejuar abuzime nga ana e IAL-ve. Të gjitha nenet që kanë të bëjnë me QSHA-në duhen rishikuar në frymën që të mos çenojnë autonominë akademike dhe institucionale të IAL-ve. Aplikimet për studimet në të tria Ciklet e studimeve (Bachelor, Master dhe Doktoraturë) duhet të bëhen drejtëpërdrejtë pranë IAL-ve. Të gjithë nxënësit apo studentët shqiptarë, të cilët dëshërojnë të kryejnë studimet Bachelor, Master dhe Doktoraturë jashtë Shqipërisë aplikojnë drejtëpërdrejtë në universitet. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se futja e studentëve nëpërmejt maturës shtetërore ka shkaktuar rënie të ndjeshme të cilësisë së kapaciteteve studentore. Përsa kohë Shqipëria synon aderimin në BE, ligjet duhet t’u përafrohen standarteve që kërkon BE-ja. IAL-të duhet të gëzojnë autonominë e plotë të përzgjedhjes së studentëve, pas një procesi të aplikimit drejtëpërdrejtë në IAL-të. Kjo do të lehtësonte procedurat duke e bërë sistemin më fleksibël e më pak burokratik. Shtimi i strukturave ndërmjetëse veçse krijon vonesa dhe vështirëson

procesin, duke lënë vend për mungesë transparence, për abuzime e korrupsion.

Gjithashtu, në shkelje të autonomisë akademike, politike e më gjerë janë edhe nenet si vijojnë: neni 18 (3,6), neni 20 (3), neni 63, neni 64, neni 101 etj.

2.Autonomia institucionale

Projektligji rreshton një sërë institucionesh (qendra, agjenci, institute etj) që, pa dyshim, financohen nga taksat e taksapaguesve shqiptarë, krijohen e funksionojnë jashtë IAL-ve duke u marrë këtyre të fundit kompetenca dhe duke u imponuar rregulla të cilat cënojnë rëndë autonominë institucionale të IAL-ve. Krijimi i hallkave në vertikalizimin e pushteteve krijon veçse një zinxhir të panevojshëm burokratik me kosto të lartë financiare, çon në kolaps mbarëvajtjen e IAL-ve duke u imponuar atyre rregulla që përcaktohen me Vendime të qeverisë.

Mënyra e organizimit të IAL-ve, kompetencat që u jepen autoriteteve dhe organeve kolegjiale lë shkas për abuzime e mbivendosje kompetencash.

Kështu, **neni 7, pika 3, gërma ‘c’ e ‘ç’**, ku parashikohet shkarkimi i autoriteteve drejtuese Rektor, Dekan. Nëpërmejt këtyre paragrafëve Ministrit i hapet rruga të shkarkojë në mënyrë të paligjshme rektorin, duke e konsideruar këtë të fundit vartës si dhe të shkarkojë autoritete të tjera drejtuese po në mënyrë të paligjshme.

Republika e Shqipërisë, në organizimin e vet shtetëror ka ndarje të pushteteve ekzekutuese e legislative. Kështu, Rektori nuk duhet të jetë kryetar i Senatit akademik. Kryetari i Senatit duhet të zgjidhet nga anëtarët e Senatit me votim të fshehtë dhe vetëkandidim të këtyre të fundit. Kjo do të rriste transparencën dhe nuk do të lejonte akumulimin e pushteteve vetëm tek 1 individ. Sa për shembull: Kryetari i Bashkisë apo i Komunës nuk është njëherazi edhe kryetar i këshillit bashkiak apo komunal; kryetari i qeverisë nuk është edhe kryetar i parlamentit. Pra, Rektori nuk duhet të jetë edhe kryetar i Senatit. Atij i buron e drejta të jetë anëtar i thjeshtë i Senatit. Po kështu, nëse do të parashikohej në

projektligj edhe një organizim i ngjashëm me senatin në rang fakulteti, Dekani nuk duhet të jetë edhe kryetar i senatit të fakultetit.

Gjithashtu, nenet që flasin për punësimin e stafeve akademike dhe të punonjësve të tjerë. Disa kompetenca të Rektorit duhet t'u kalojë Dekanëve dhe disa kompetenca të Senatit të IAL-së duhet t'u kalojë senatit të fakultetit. Njësia bazë duhet të ketë kompetencën e plotë të marrjes në punë të stafit akademik dhe nënshkrimin e kontratës e bën formalisht Dekani. Në këtë rast, Rektori duhet të bëjë vetëm monitorimin dhe sigurimin e transparencës së procesit në fjalë. E njëjta logjikë duhet të ndiqet edhe për punësimin e stafit jo akademik, duke i lënë kompetencë autoriteve dhe organeve brenda fakultetit, duke lejuar në këtë mënyrë procese fleksibël, të monitorueshëm e pa shuëm hallka të ndërmjetme.

3.Autonomia financiare

Qytetarët e vendeve anëtare të BE-së kanë të drejtën për arsimim të lartë sipas kushteve tashmë të njehsuara në këto vende. Studimet me kohë të plotë të Ciklit të parë dhe të dytë sipas strukturës së Bolonjës financohen nga shteti. Për Ciklin e tretë të Doktoraturës, individët apo IAL-të mund të bashkëfinancojnë studimet e Doktoratës duke garuar nëpërmjet skemave të ndryshme. Aktualisht buxheti i qeverisë, nëpërmejt fondit të pakushtëzuar, nuk mbulon pagat dhe sigurimet për punonjësit efektivë për 12 muajt e vitit. Kjo ka bërë që muajt e papaguar (2-3 muaj) të përballohen me të ardhurat e IAL-ve, të ardhura të cilat duhet të përdoren për destinacion tjetër. Financimi nga buxheti i qeverisë edhe i institucioneve të tjera të Arsimit të lartë që nuk janë publike, cënon drejtëpërdrejtë interesat e IAL-ve publike, duke favorizuar në mënyrë jo transparente financime për IAL që nuk janë publike.

Në nenin 2, pika 1 të projektligjit nënvizohet “Arsimi i lartë është shërbim publik”. Shumë universitete publike në Evropë sigurojnë arsimim falas për studentët edhe në Ciklin e parë si në Danimarkë, Zvicër, Finlandë, Norvegji, Austri, Republika Çeke, në disa lande të Gjermanisë, Skoci, Qipro, Maltë,

Greqi. Në disa shtete të tjera si Islanda, Holanda, Polonia, Sllovakia dhe Turqia studentët paguajnë edhe për Ciklin Bachelor. Në vende të tjera të Evropës tarifa e shkollimit përcaktohet në raport me të ardhurat individuale ose familjare si në Belgjikë, Estoni, Francë, Hungari, Itali, Letoni, Rumani. Nisur nga sa më lart, institucionet publike mbështeten financiarisht nga shteti si detyrim kushtetues që shteti ka për qytetarët e tij.

Disa sugjerime:

Projektligji, në tërësinë e vet, bie ndesh me Kushtetutën dhe standartet e parimet e Kartës së Bolonjës. Sugjerojmë që projektligji të ripunohet në respekt të Kushtetutës së RSH dhe të parimeve të Bolonjës.

Nëse ky projektligj do të kthehej për ripunim do të sugjeronim:

1.Ciklet e studimeve

Në respekt të parimeve të Kartës së Bolonjës, Ciklet e studimeve mund të jenë si më poshtë

Cikli i parë ku mund të përfshihen:

- a.Arsimim i lartë profesionale (120 ects)
- b.Cikel i parë arsimim profesional (180-240 kredite)
- c.Cikël i parë arsimim akademik (180-240 ects)

Studenti që përfundon Ciklin (b) dhe (c) mund të ndjekë:

Cikli i dytë:

- a.Master (60-120 kredite)

Studenti që përfundon Master me 120 kredite (Master i shkencave) mund të ndjekë:

Cikli i tretë:

a.Doktoraturë (3-5 vjet)

Në nenin 80 “Programet e Ciklit të tretë” sugjerojmë të hiqet “Masteri ekzekutiv” si një hallkë e tepërt e studimeve, duke përcaktuar që koha e studimeve të Doktoratës të ketë afat 3 deri në pesë viteve, përgjatë të cilës studenti doktorant i nënshtrohet Shkollës doktorale. Vetëm pas përfundimit me suksese të shkollës doktorale, studenti mund të vijojë më tutje me përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës.

2.Struktura e IAL-ve

Në lidhje me Bordin administrativ të Universitetit: Në përbërjen e tij, të ketë maxhorancë nga stafi akademik dhe jo akademik i universitetit.

Në lidhje me Fakultetin: Të parashikohet një Senat në rang fakulteti, me anëtarë të zgjedhur nga stafi akademik, jo akademik e studentor si dhe anëtarë nga jashtë fakultetit.

Gjithashtu, në nivel fakulteti: të hiqen administratorët e njësive bazë dhe të konceptohet një Bord administrativ i Fakultetit

3. Kategoritë e personelit akademik

Neni 62 ka përplasje ndërmejt pikave. Kështu, në pikën 6, personeli, i punësura për herë të parë në IAL që mban gradën shkencore “Doktor” quhet ndihmës-lektor dhe është i barabartë me personelin pa Gradë shkencore që ka përfundura “Master i shkencave”. Sugjerojmë që personeli që do të punësohet për herë të parë në IAL të ketë Gradën shkencore “Doktor i shkencave”, duke fitur menjëherë statusin “Lektor”.

4.Kohëzgjatja e punësimit

Neni 69, pika 1 dhe 2 lë mjaft vend për abuzim dhe mungesë transparence. Personeli me titull “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjec. Pas mbushjes së kësaj moshe, ai mund të angazhohet vetëm si pedagog i jashtëm, nëse njësia bazë e kërkon një gjë të tillë. Gjithashtu, personeli me titull “Profesor i asociuar” shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç dhe pas kësaj moshe, ashtu si në rastin e Profesorit, mund të angazhohet si pedagog i jashtëm, nëse njësia bazë do ta gjykojë të arsyeshme. Lënia e afatit të rinovimit të kontratës pa limit kohor është mjaft jo transparente dhe vonon zëvendësimin e trupës akademike me staf të ri, duke i penguar këta të fundit në të drejtën e tyre të punësimit.

Përfundime

Nisur nga koha mjaft e shkurtër që patëm në dispozicion për të lexuar dhe bërë komentet tona rreth projektligjit, gjykojmë se projektligji në tërësi ka përplasje me Kushtetutën e RSH dhe Parimet e Kartës së Bolonjës. Projektligji është diskriminues ndaj institucioneve të arsimit të lartë public.

Mendimet tona do t’i parashtrojmë edhe në mbledhjen e Senatit të UT-së

KRYETARE

Prof.Dr. Klodeta Dibra